



Prishtinë / Prishtine / Pristina	21.02.2022	2	vite / god / year
Organ / Zëritar / Organ / Zëritar / Organ / Zëritar	No. Pror / No. Pror / No. Pror	Shtesa / Filling / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKM/SHCK/911/2022			1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.37/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1568/20 të datës 13.01.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.208/2020 të datës 03.08.2020, të parashtruar nga ankuesi ne adresë banimi:

kundër Vendimit me numër protokoli 5616 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.208/2020 e datës 03.08.2020, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 5616 i datës 28.07.2020, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me datë 03.08.2020 ka parashtruar ankesë më numër të protokollit 1446/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 5616 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) me datën 13.08.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (tutje MIT), ndërsa me datë 17.08.2020, Këshilli ka pranuar vetëm dokumentacionin me provat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Njoftimit me numër protokollit 1764/2020 të datës 15.09.2020, ka informuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën me numër A.nr.208/2020 të datës 03.08.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 13.01.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.1568/20, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 15.09.2020 të KPMSHCK-se dhe ka obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë(30) ditësh, të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër A.nr.208/2020 të datës 03.08.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1446/2020 të datës 03.08.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër protokollit 1764/2020 të datës 15.09.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër protokollit 1860/2020 të datës 22.09.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.08.2020; Përgjigjen në ankesë të datës 17.08.2020 nga Ministria e Infrastrukturës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kërkesën e datës 09.07.2020 për fillimin e procedurës disiplinore; Opinionin e datës 09.07.2020 nga Agjencia Kundër Korrupsionit; Vendimin me numër protokollit 5616 të datës 28.07.2020 e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës; Procesverbalin e datës 27.07.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me numër 1422 të datës 12.02.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me numër protokollit 21.12.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me numër protokollit 1422 të datës 12.02.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës; Akt emërimit e ankuesit të datës 13.04.2012; Padinë e datës 23.09.2020 e parashtruar nga ankuesi për Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimin e datës 03.11.2021 për përgjigje në padi nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në padi të datës 16.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 10.01.2022; Autorizimin e datës 11.01.2022; Procesverbalin me numër A.nr.1568/2020 të datës 12.01.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin me numër A.nr.1568/2020 të datës 13.01.2022 i cili në Këshill është pranuar me datën 21.01.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin me numër protokollit 1447 të datës 06.11.2018 për Themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin me numër 752/2019 të datës 28.01.2019, Akt Emërimit e datës 23.05.2017 për Nazmi Gashin, Akt Emërimit e datës 11.09.2017 për Rexhë Osmanaj, Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të datës 23.04.2019, Vendimin me numër protokollit 5308 të datës 17.05.2019 të Komisionit Disiplinor, Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të datës 08.05.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Sipas provave të lëndës respektivisht Akt emërimit të datës 07.07.2014 rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës në pozitën “Udhëheqës i Divizioni të Licencimeve dhe Rregullimit Ekonomik”, në kuadër të Departamentit të Aviacionit Civil. I njëjti me Vendimin me numër protokoli 11941 të datës 20.12.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm të MIT-së ishte caktuar në pozitën ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit të Aviacionit Civil, ndërsa me Vendimin me numër protokoli 1422 të datës 12.02.2019, po të Sekretarit të Përgjithshëm ishte caktuar anëtar i Komisionit Disiplinor pranë kësaj ministrie.

Me tej, nga provat e lëndës rezulton se Agjencia kundër Korrupsionit sipas denoncimit të Avdi Kamerollit, me datë 02.07.2020 përmes shkresës me numër AKK-DPK1-06-1175/19 ka dhënë opinion përmes të cilit kishte konfirmuar se: *Është shfaqur situata e konfliktit të interesit “rast për rast” për zyrtarin. i cili kishte marrë pjesë në procedurën disiplinore, sipas vendimit Nr.01/5308 të datës 17.05.2019, përmes të cilit vendim i është shqiptuar masa disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës së Ankuesi në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit, në Departamentin e Aviacionit Civil në MTI, duke marrë pjesë në këtë vendimmarrje ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.* Kurse përmes shkresës me numër AKK-DPK1-06-1175/19 të datës 02.07.2019, ka rekomanduar inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit Në këtë kontekst, e bazuar në rekomandimin në fjalë, Sekretari i Përgjithshëm i MTI, ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor i MIT-së që të zhvillohet procedura disiplinore ndaj ankuesit në mënyrë që të vërtetohej shkelja e supozuar lidhur me konfliktin e interesit.

Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër protokoli 5616 të datës 28.07.2020, ka shpallur përgjegjës ankuesin me arsyetimin se i njëjti nuk i është shmangur konfliktit të interesit “rast për rast” në rastin e vendimmarrjes në procedurën disiplinore kundër duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe Kodin të Mirësjelljes në Shërbim Civil, dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar masën disiplinore “Largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për një periudhë deri 5 vjet”.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, konstatim jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Me tej thekson se, Komisioni Disiplinor nuk ka qenë i formuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 49 paragrafi 1 lidhur me nenin 5 paragrafi 1 pika 1.6 të këtij Ligji dhe se Komisioni Disiplinor, procedurën disiplinore ndaj ankuesit e ka zhvilluar sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i cili është shfuqizuar me nenin 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua :

Neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se: *Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit.*

Neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i Rregullores Nr.04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil parasheh se: *shkelje të rënda-serioze konsiderohen ; ...1.13 dështimi ose dhënia e deklaratës së rrejshme lidhur me konfliktin e interesit..*

Rregullorja (QRK) Nr.4/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 14 parasheh qe: *...Nëpunësi civil ushtron funksionin e tij në pajtim me Ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit duke përfshirë por mos u kufizuar në Kodin përkatës Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin përkatës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, 3.Nëpunësi civil gjatë kryerjes së detyrës kur ka dijeni për ekzistimin e konfliktit të interesit është i detyruar që: 3.1. të identifikoj nëse ka një konflikt të mundshëm të interesit; 3.2. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur vet konfliktin e interesit. Neni 15: Shmangia e konfliktit të interesit 1. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë në bazë të të dhënave që disponon, duhet të ndërmerr masat e nevojshme që të shmangët emërimin ose zgjedhja e një personi në pozicione në të cilat mund të lindë ose ka konflikt të interesit. 2. Nëpunësi civil nuk mund të ngarkohet me detyra që mund të çojnë në lindjen e konfliktit të interesit. 3. Nëpunësi civil i cili ka interesa që vazhdimësia e zotërimit të tyre do të përbënte rrezik real për lindjen e konfliktit të interesit dhe do të sillte përjashtimin e vazhdueshëm nga veprimtaria e tij zyrtare ose pamundësinë për të ushtruar detyrat zyrtare, duhet të heqë dorë ose t'i transferoj këto interesa në mënyrë që të shmangë konfliktin e interesit.*

Ligji Nr.06/l-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni : përcakton që: *Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private. 2. Në rast se zyrtari ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërliohen me këtë çështje, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin. 3. Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit. 4. Në rast se udhëheqësi apo institucioni udhëheqës nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe vetë ka ose mund të ketë konflikt të interesit, atëherë i drejtohet Agjencisë për marrje të vendimit për rastin.*

Ndërsa Ligji Nr.05/031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht me nenin Neni 29 përcaktohet se: *1.Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërën nga këto situata: ... 1.10 në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij. Kurse neni 30 parasheh se: 1. Kur gjendet apo dyshon se është në një situatë sipas nenit 29 të këtij Ligji, nëpunësi apo anëtar i organit kolegjal, menjëherë me njohjen e shkakut, tërhiqet nga pjesëmarrja në procedurën administrative dhe njofton eprorin e vet gjegjësisht organin kolegjal. 2. Çdo nëpunës që ka dijeni për gjendjen e një nëpunësi tjetër në konflikt interesi sipas nenit 29 të këtij ligji, ka detyrimin të njoftojë organin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.3. Pala, gjithashtu, mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtar të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në çastin e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi.*

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lart si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin ka konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 07.07.2014, ka qenë i emëruar dhe ka ushtruar detyrën e Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit dhe Rregullimit Ekonomik në kuadër

të Departamentit për Aviacion Civil dhe se i njëjti në cilësi të anëtarit të Komisionit Disiplinor kishte marrë pjesë në procedurën disiplinore të iniciuar ndaj ish Udhëheqësit të tij të drejtpërdrejt në pozitën e Drejtorit të Aviacionit Civil, dhe e cila procedurë kishte rezultuar me ndërprerje të marrëdhënies së punës së Po ashtu, Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë shkresë që dëshmon se ankuesi ka ndërmarr ndonjë veprim për shmangie të konfliktit të interesit për rastin në fjalë, edhe pse sipas Procesverbalit të Komisionit Disiplinor të datës 24.03.2019. kishte pyetur anëtarët e Komisionit Disiplinor nëse ndonjëri nga ta mund të ishte në konflikt të interesit në rastin e tij, me ç'rast që të gjithë anëtarët e Komisionit Disiplinor kishin pohuar se nuk ndodhen në konflikt të interesit, kështu që procedura disiplinore ka vazhduar me përbërjen e njëjtë të anëtarëve të Komisionit Disiplinor, e si rrjedhojë Kolegji bazuar në konstatimet si me lartë, vlerëson se Komisioni Disiplinor i MIT-së me vendimin e kontestuar me ankesë, ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil, dhe ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, duke vepruar kështu në pajtueshmëri të plotë me nenin 66 paragrafin 1 dhe nenin 67 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të këtij Ligji.

Lidhur me pretendimin ankimor se procedura disiplinore ndaj ankuesit është zhvilluar sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i cili është shfuqizuar me nenin 85 të Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji pasi ka analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë në kohën kur ka qenë në zbatim Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil Kosovës dhe se në provat e lëndës Kolegji nuk ka hasur në ndonjë kërkesë të ankuesit sipas se cilës i njëjti të ketë kërkuar vazhdimin e procedurës disiplinore në fjalë sipas ligjit të ri ashtu siç përcaktohet me nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e mbi këto arsye rezulton se është i pabazuar pretendimi ankimor si me lartë.

Përkitazi me pretendimin se Komisioni Disiplinor i MIT-së, nuk ka qenë i formuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji nisur nga konstatimi se procedura disiplinore ishte iniciuar dhe zhvilluar sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj edhe Komisioni Disiplinor ishte formuar sipas nenit 70 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe me nenin 9 paragrafi 3 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, e ndërlidhur me këtë edhe pretendimi i ankuesit është i pa qëndrueshëm.


Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.37/2022

Ardita Perçuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- *në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;*
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

